




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>20/DPK</u>	Nr Prot. Br. Prot. <u>01-3395/14</u>
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages <u>03</u>	Data Datum <u>26.09.2014</u>
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	23.09.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	znj. Besa GAXHERRI Deputet në Kuvendin e Kosovës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik



E nderuara znj. Gaxherri,

Lidhur me kërkesën tuaj drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit (DPK-03-2791/14), ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejshëm LPKI), Agjencia, ndër të tjera, bën këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të epnoreve, të institucioneve epnore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave (neni 19, pika 1.5). Agjencia, ndër të tjera, "bën këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të epnorëve, të institucioneve epnore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin rast për rast të interesave", si dhe ofron opinione dhe ndërmerr të gjitha masat tjera ligjore me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit dhe të korrupsionit në tërësi. (Neni 19, pika 1.5, dhe 1.6 të Ligjit Nr.04/L-051).

Prandaj, bazuar në kërkesën tuaj, se a paraqet konflikt interesi ushtrimi i funksionit të menaxherit regional i Postës së Kosovës në Regjionin e Pejës krahas ushtrimit të funksionit të deputetit të Kuvendit të Kosovës, duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, kemi nxjerr këtë:

OPINION

Ekziston papajtueshmëri dhe kufizim në ushtrimin e funksionit publik, si deputet i Kuvendit të Kosovës dhe menaxher regional i Postes së Kosovës në regjionin e Pejës.

Arsyetim

Në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit pozita juaj si deputet i Kuvendit të Kosovës, hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik.

Sipas këtij ligji, të gjithë zyrtarët e lartë publik kanë për obligim parandalimin e konfliktit të interesit dhe kanë për detyrë të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit (neni 8, par. 1).

LPKI po ashtu parasheh parimet e veprimit dhe mos veprimit të zyrtarit të lartë. Disa prej këtyre parimeve të parashikuara në këtë ligj janë se zyrtari i lartë, gjatë ushtrimit të funksionit publik, duhet të veprojë në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejtë që interesin e tij privat ta vërë para interesit publik, për mbrojtjen e të cilit është zgjedhur apo emëruar. Pastaj, zyrtari i lartë duhet të kryej punën e tij me ndershmëri, ndërgjegje, paanshmëri, të ruajë autoritetin e zyrtarit të lartë dhe institucionit dhe me punën e tij të rrisë besimin e qytetarëve në institucione. Po ashtu zyrtari i lartë nuk duhet të lejojë që interesat e tij private të bienë në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm.

Lidhur me pyetjen tuaj se a ekziston konflikt interesi në ushtrimin e funksionit tuaj publik si deputet i Kuvendit të Kosovës dhe menaxher regional i Postes së Kosovës në regjionin e Pejës, kushtetuta e Kosovës ka paraparë disa kufizime.

Kufizimet e tilla kushtetuta i ka emëruar si papajtueshmëri, të cilat janë vënë me qëllim të sigurimit të pavarësisë së plotë të deputetit dhe ushtrim të paanshëm të funksionit të tij. Kjo si pasojë e asaj se aktivitetet e caktuara jashtëparlamentare, mund të ndikojnë në masë të konsiderueshme në pavarësinë e deputetit. (Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Botimi I).

Neni 72 i Kushtetutës parasheh se:

“Deputeti i Kuvendit të Kosovës nuk mund të mbajë ndonjë post ekzekutiv në administratën publike ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi publike, dhe as të ushtrojë ndonjë funksion tjetër ekzekutiv, sikurse është përcaktuar me ligj”.

Bazuar në këtë dispozitë, ushtrimi i njëkohshëm i funksionit të deputetit dhe të qenurit menaxher në ndërmarrjen publike “Posta e Kosovës” është i papajtueshëm. Arsyet për këtë janë të sqaruara në paragrafin e mësipërm.

Përveç Kushtetutës së Kosovës, edhe LPKI i ka paraparë disa kufizime për zyrtarët e lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik. Kufizimet e tilla janë paraparë në nenin 16.

Në piken 1 të këtij neni thuhet:

Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike, si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit.

Bazuar në këto dispozita është e qartë se deputeti i Kuvendit të Kosovës, nuk mund të ushtroj këtë funksion në Postën e Kosovës, prandaj ju rekomandojmë që të veproni konform këtij opinioni.

Me respekt!

